



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe nenit 17, pika b të Ligjit nr. 03/L - 040 për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15, qershor 2008), nenit 11, paragrafi 1, pika 1.15, nenit 17 paragrafi 5, nenit 20 dhe nenit 26 të Ligjit nr. 04/L -174, për planifikimin hapësinor, nenit 7, paragrafi 2 të Udhëzimit administrativ nr. 05/2014, për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor, si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, dhe të nenit 34, paragrafi 34.1 pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 19.05.2017, merr këtë

V E N D I M
PËR LËNIEN NË DISPOZICION PËR SHQYRTIM PUBLIK TË
PROPOZIMPLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM PËR TËRËSINË
URBANE "B" TË LAGJES "PRISHTINA E RE - ZONA LINDJE" 2017-2025

Neni 1

Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

- 1.1. Miratohet Vendimi për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" 2017-2025.
- 1.2. Propozimplanin nga pika I e këtij vendimi përbëhet nga pjesa tekstuale dhe grafike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi.

Neni 2

Konsultimet publike

- 2.1. Propozimplanin rregullues i hollësishëm, i cekur në nenin 1 të këtij vendimi, u lihet në dispozicion për shqyrtim publik qytetarëve, agjencive, departamenteve dhe organeve të tjera për shqyrtim dhe komente, në afat prej 30 ditësh.
- 2.2. Organizimin e shqyrtimit publik të Propozimplanit do ta bëjë Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- 2.3. Pas përfundimit të kohëzgjatjes së shqyrtimit publik, projektplanin final, së bashku me një përmbledhje të shkurtër të komenteve të bëra gjatë diskutimit publik - raportin, do t'i dorëzohen Kuvendit të Komunës së Prishtinës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

Neni 3
Subjekti përgjegjës

- 4.1. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.
- 4.2. Organet tjera përkatëse kompetente do t'i kryejnë veprimet procedurale për zbatim të këtij Propozimplani nga përgjegjësitë e tyre të parapara sipas Vendimit për organizimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të Administratës komunale.

Neni 4
Kufiri i territorit

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm, përfshinë një sipërfaqe prej S= 109.72 Ha. Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të zonave kadastrale: Matëan, Zllatar dhe Hajvali.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb – faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-350/05-0118255/17, më 22.05.2017



ARSYETIM

i Vendimit për lënie në dispozicion të Projektplanit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje"

Duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit nr. 04/L-174, për planifikim hapësinor, dhe në kërkesat e pronarëve të tokave (sipas kufirit të propozuar për trajtim) marrëveshjeve të arritura mes pronarëve dhe investitorëve, por edhe duke e parë interesin e Komunës së Prishtinës për realizimin e planeve rregulluese urbane ekzistuese, Komuna e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për një pjesë të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" i cili plan më pas do të inkorporohet në Hartën zonale të Komunës së Prishtinës.

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e tetë, të mbajtur më 06.12.2016, ka marrë vendim për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për tërësinë urbane "B" të lagjes "Prishtina e Re - Zona Lindje" dhe vendimi është publikuar në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës.

Komuna e Prishtinës, përkatësisht Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, duke u bazuar në nenin 11, pika 1.6.1 e Ligjit nr. 04/L-174, përmes koordinimit të drejtorive sektoriale dhe burimeve të veta njerëzore ka hartuar Planin rregullues të hollësishëm.

Zona për të cilën do të hartohet Plani rregullues i hollësishëm, është zonë e përcaktuar sipas Planit zhvillimor komunal, i miratuar nga Kuvendi i Komunës me Vendimin nr. 01- 031-156871, dt. 27.08.2013 dhe Planit zhvillimor urban, i miratuar nga Kuvendi i Komunës me Vendimin nr. 01-035-181427, dt.24.09.2013. Po ashtu, kjo zonë gjendet brenda Planit rregullues "Prishtina e Re - Zona Lindje", i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 035-186833, dt. 02.10.2013.

Pasi që Plani rregullues aktual dhe Plani zhvillimor urban kanë mospërputhje jo vetëm në strukturën urbane, por edhe në infrastrukturën e planifikuar rrugore, gjegjësisht banimi individual sipas Planit rregullues aktual është i shtrirë në luginën e përroit, ku zbatimi i këtij plani është i pamundshëm, por edhe infrastruktura rrugore e planifikuar nuk është e bazuar në gjendjen faktike të terrenit, ku sipas kësaj realizimi i infrastrukturës paraqet një sfidë të madhe për Komunën e Prishtinës.


Zona për të cilën do të hartohet Plani rregullues i hollësishëm përfshinë sipërfaqen prej S= 109.72 ha. Parcelat që bëjnë pjesë në këtë zonë shtrihen në kuadër të zonave kadastrale: Matçan, Zllatar dhe Hajvali.

Plani rregullues i hollësishëm ka caktuar kushtet ndërtimore sipas Ligjit për planifikim hapësinor 04/L-174 dhe Udhëzimit administrativ për zbatimin e Ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të Planit rregullues, me nr. 41, 02/05 (bazuara në interpretimet e dhëna nga MMPH-ja).

Projektplani rregullues i hollësishëm është finalizuar duke u bazuar në nenin 7, pika 2, të Udhëzimit administrativ për përgjegjësitë e autoritetit të planifikimit hapësinor,

si dhe Parimet dhe proceduarat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor, nr. 05/2014. Komuna do ta vë draftin në dispozicion të publikut, grupeve të interesit, departamenteve dhe agjencive të tjera qeveritare për shqyrtim dhe komentim dhe kjo periudhë do të zgjasë 30 ditë.

Pas shqyrtimit publik, Komuna do t'i shqyrtojë, analizojë dhe inkorporojë propozimet që do të rrjedhin nga debati publik dhe do ta dorëzojë Projektplanin rregullues të hollësishëm në Kuvendin e Komunës për miratim përfundimtar.



----- Kufiri i trajtuar